

**VENDIM**  
**Nr. 497, datë 13.9.2017**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË ISH-GODINËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE, NGA MINISTRIA E KULTURËS KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE KOMISIONERËVE PUBLIKË, INSTITUCIONE TË RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR. 84/2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës, për sistemimin me mjedise pune të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë, sipas hartave treguese dhe kartelave të pasurisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve u jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë deri në përfundim të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë (procesi i *vetting*-ut).

3. Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Autorizohet Ministria e Kulturës për nënshkrimin e kontratës përkatëse.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



## HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT  
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME  
TIRANË

REGJISTRUES  
Lediana Bardhi

Vula/Firma

### A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8380  
NR. I PASURISE: 2/99 VOL 11 FO 189  
INDEKSI I HARTES: TR:0-10 SHKALLA: 1:500  
ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANË Q/F TIRANË  
Rr/L: "e KAVAJES" P/G     SH     K     Ap    

### B. KUFIZIMET

V. 2/101; 2/319  
L. 2/323  
J. 2/142  
P. 2/100; 2/141

### C. PRONARI

NË PËRQËSËSI ADMINISTRIM  
TË MINISTRIËS KTR

D. Data: 11.07/2017





| Nr.Dok   | Data Regjistrimit | Tipi | Pershkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma                                                                               |
|----------|-------------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| 00016247 | 20/02/2017        | L1   | BAZUAR VEND GJ APELIT TIRANE ME NR.1366, DT 02.06.2015 I CILI NDRYSHON VENDIMIN NR.9744, DT 09.10.2014 TE GJYKATES SE SHKALLES TIRANE, KU URDHEROHET: FSHIRJA E TE DREJTAVE REALE TE KMSH TE FITUAR ME VENDIMIN 345, DT 24.09.2000 TE K.K.K PRONAVE, NE ZVRPP DHE REGJISTRIMIN NE FAVOR TE TARIKATIT ISLAMIK HALVETIAN |                           |         |  |
|          |                   |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                           |         |                                                                                     |

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|--------|-------------------|------|------------|---------------------------|---------|-------|
|        |                   |      |            |                           |         |       |

TIRANË, me 11 / 7 / 2017

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me originalin e ndodhur në zyrën tone  
Në regjistrin Vol 11 , Faqe 189 , Zona Kadastrale 8380 , Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI  
LEDIANA BARDHI







## HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT  
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

TIRANË

REGJISTRUES

Lediana Bardhi



Vula/Firma

### A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8380

NR. I PASURISE: 2/100 VOL 11 FQ 182

INDEKSI I HARTES: TR:0-10 SHKALLA: 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANË Q/F TIRANË

Rr/L: "KAJO KARAFILI" P/G SH K Ap

### B. KUFIZIMET

V. 2/101

L. 2/99

J. 2/141

P. 2/140

### C. PRONARI

NË PËRQËSËSI ADMINISTRIM  
TË MINISTRIË KTR

D. Data: 11/07/2017









| Nr.Dok   | Data Regjistrimit | Tipi   | Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma                                                                               |
|----------|-------------------|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| 00016347 | 20/02/2017        | RF4_AV | BAZUAR VENDIMET GJAEPELIT TIRANE NR.1366,DT 02.06.2015, I CILI NDRYSHON VEND NR.9744,DT 09.10.2014 TE GJYKATES SE SHIKALLES SE PARE TIRANE, KU URDHEROHET: FSHIRJA E TE DREJTAVE REALE TE KMSH, FITUAR ME VENDIMIN NR.345,DT 24.09.2000 TE K.K.K.P, NE ZVRPP DHE REGJISTRIMIN NE FAVOR TE TARIKATIT ISLAMIK HALVETIAN. |                           |         |  |
|          |                   |        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                           |         |                                                                                     |

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Certifikatës | Shenime | Firma |
|--------|-------------------|------|------------|---------------------------|---------|-------|
|        |                   |      |            |                           |         |       |

REGISTRUESI  
LEDIANA BARDHI



